



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë <i>p.p. CMIJEXU</i> Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/ME <i>D.Krasniqi</i> Datë: 16.04.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Udhëheqës i Divizionit për Politika të NP/NJPMNP <i>D.Pllashniku</i> Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP <i>Arbërore</i>
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Pejës
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 17/2026 i Kuvendit të Komunës së Pejës

I nderuar Kryetar z. Muhaxheri,
I nderuar Kryesues z. Kurtbogaj,

Ministria e Ekonomisë ka pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. prot. 574 datë 02.04.2026, për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal të Komunës së Pejës, Vendimin Nr.17/2026 mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale (N.P.L.) " Stacioni i Autobuseve " Sh.A., të miratuar më datë 31.03.2026 nga Kuvendi Komunal i Pejës.



Bazuar në nenin 9, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, dhe legjislacionin përkatës për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, vlerëson se Vendimin Nr.17/2026 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale (N.P.L.) "Stacioni i Autobuseve" Sh.A., është në përputhje me ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Arsyetim

Vendimi Nr. 17/2026 mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale (N.P.L.) "Stacioni i Autobuseve" Sh.A. mbështetet në legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike

Pas pranimit të dorëheqjes së anëtarit, Komuna e Pejës, në cilësinë e aksionarit, ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për zëvendësimin e tij, me qëllim sigurimin e funksionimit të plotë dhe efektiv të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neni 5 paragrafi 5.2. i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton se: "Kur një komunë është aksionare në një Ndërmarrje Publike Lokale, të drejtat e saj të aksionarit ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar."

Mbi këtë bazë, Vendimi i Komunës së Pejës që zëvendëson anëtarin e dorëhequr të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale përmes të cilit mundësohet përbërja e plotë dhe funksionimi i komisionit me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse në ndërmarrjen publike lokale, është në harmoni me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

Ministria e Ekonomisë mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

** Vlerësimi i dhënë nga Ministria e Ekonomisë përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë si sponsorizuese e legjislacionit për Ndërmarrjet Publike**





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Pejës Kryesuesi i KK - Pejë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Veton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbllin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Data: 02.04.2026 VI-020-162/17
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës: Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendëve Komunale dhe Akteve të Kryetarit 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse: Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Shkresë përcjellëse në ME	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr.17/2026 mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHLA Pejë, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Pejës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr.17/2026 mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SHLA Pejë

I miratuar më datë: 31.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.04.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA

HYRËSE	REKORDING
Ministria e Administrimit Lokal	Ministria e Administrimit Lokal
02.04.2026	
-01-	02/162/17

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I. Numër: 016/01-16804, dt. 31 Mars 2026.

Në bazë të nenit 11 e nenit 12.2 pika d) dhe nenit 25.2 të Ligjit Nr.03/L - 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 datë: 04 qershor 2008"), nenit 5, paragrafi 2. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës Nr.03/L - 087 datë: 13 qershor 2008, nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Mars 2026, marr:

VENDIM

Nr.17/2026

mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PEJË

1. Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i anëtarit të Komisionit Komunal i Aksionarëve për ushtrimin e të drejtës aksionare të Komunës së Pejës, në N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" sh.a. me seli në Pejë, si vijon:

1.1. Anëtarja e kuvendit znj. Fatime Shala, nga subjekti politik PDK, emërohet anëtare i KKA në N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" sh.a. me seli në Pejë, në vend të anëtarit të dorëhequr nga pozita e anëtarit të kuvendit z. Alibi Shala, nga i njëjti subjekt politik.

2. Anëtar i Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi do të ushtrtojë të drejtën e Komunës së Pejës, si aksionare në N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" sh.a. me seli në Pejë, konform nenit 5, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, si dhe dufiet të veprori në përputhje me Ligjin Nr. 06/L - 016 për Shoqëritë Tregtare.

3. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Pejës.

4. Me këtë vendim bëhet ndryshimi i pikës 1, paragrafi 1.3. i Vendimi Nr. 05-2026 mbi themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PEJË, me nr. protokollit: 016/01-8782, dt.26 Shtat 2026.

5. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gazetë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendim i dërgohet:
 MAPL,
 Kryetari të Komunës,
 DSH dhe institucione të zgjedhur, Arkivë.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEÇ

HYTËSE - H		KOMUNAL	
Ministria e Administratës Lokale Ministry of Local Government Administration		Pejë Local Government Administration	
Datë	02.04.2026		
Titulli			
Numri i dokumentit	01-016/01-16804		

SKUPŠTINA OPŠTINE PEÇ

I. Broji: 016/01-16804, datum: 31. marti 2026.

Na osnovu člana 11 i člana 12.2 tačka d), i člana 25.2 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi Republike Kosovo („Službeni glasnik Republike Kosovo“, br. 28, datum: 4. jun 2008), člana 5 stav 2 Zakona o javnim preduzećima Republike Kosovo br. 03/L-087 od 13. juna 2008; člana 20 stav 1 tačka 1.4 Statuta br. 01/2020 Opštine Peç, i br. 01-016/01-41343 od 30. septembra 2020; Skupština opštine Peç, na sednici održanoj dana 31. marta 2026, donosi:

OBLUKU

Br. 17/2026

o zameni člana Opštinske komisije akcionara JP „AUTOBUSKA STANICA“ AD Peç

1. Ovom odlukom vrši se zamena člana Opštinske komisije akcionara za ostvarivanje akcionarskog prava Opštine Peç u JP „Autobuska stanica“ AD sa sedištem u Peçi, kako sledi:

1.1. Član skupštine g. Fatime Shala, iz političkog subjekta PDK, imenjuje se za člana OKA u JLP „Autobuska stanica“ AD sa sedištem u Peçi, umesto člana koji je podneo ostavku, g. Albi Shala, iz istog političkog subjekta.

2. Član Komisije iz tačke 1 ove Odluke vršiće pravo Opštine Peç kao akcionara u JLP „Autobuska stanica“ AD sa sedištem u Peçi, u skladu sa čl. 5 stav 2 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, kao i u skladu sa Zakonom br. 06/L-016 o trgovačkim društvima.

3. Za sprovođenje ove Odluke staraće se predsednik Opštine Peç.

4. Ovom odlukom vrši se izmena tačke 1, stav 1.3. Odluke br. 05-2026 o osnivanju Opštinske komisije akcionara JLP „AUTOBUSKA STANICA“ AD Peç, prot. br. 016/01-8782, od 26. februara 2026.

5. Ova odluka se objavljuje trideset (30) dana nakon registracije u Kancelariji protokola Ministarstva za Administraciju Lokalne vlasti i stupa na snagu sedam (7) dana nakon objavljivanja na zvaničnim jezicima na web-stranici Opštine Peç.

Ostavlja se dostavljati:

MALV-a,
Predsednik Opštine,
za budžet i finansije i izabranim članovima,
Arhiv.

